



Tiranë

08/06/2022

Kontakt:

Elton Tirana

E-mail:

elton.tirana@studiotirana.com

Cel: +355 699 325 722

Drejtuar : Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Rr. Ibrahim Rugova, Nr. 4, Tiranë 1007

Në vëmendje të: Z. Ylli Merkaj

**Objekti: Njoftim për mosrealizimin e Kontratës së Auditimit për subjektin
“Partia Alternative Republikane”**

Të nderuar Zotërinj,

Bazuar në Kontratën nr. Prot. 2336, datë 09/05/2022 lidhur me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) në cilësinë e Ekspertit Kontabël të Liçensuar (Auditues Ligjor) me misionin e auditimit të fondeve të përfituara dhe shpenzimeve për vitin kalendarik 2021 për subjektin “Partia Alternative Republikane” ju bëj me dijeni si vijon:

Menjëherë pas lidhjes së Kontratës me KQZ-në, më datë 30/05/2022 kërkuam të vendosnim komunikimin zyrtar me subjektin “Partia Alternative Republikane” për fillimin e procedurave të auditimit, nëpërmjet dërgimit me postë të një shkrese informuese me kthim përgjigje në adresën e selisë së Partisë vënë në dispozicion nga KQZ-ja.

Por, kjo mënyrë komunikimi rezultoi pa sukses, pasi nga posta letra u kthye mbrapsht në adresën tonë me përgjigjen: I Panjohur.

Gjithashtu, nga ana jonë pati përpjekje për të gjetur të dhëna dhe kontakte të tjera online dhe nga auditues të tjerë të mëparshëm për këtë subjekt, por pa rezultat.

Ne besojmë se kemi bërë përpjekjet e duhura për të vendosur komunikimin zyrtar me Kryetarin dhe personat e tjerë përgjegjës në këtë Parti, por kjo qe e pamundur dhe për rrjedhim misioni i auditimit për Partinë Alternative Republikane nuk u realizua.

Bashkangjitur dokumentacioni vërtetues: Letra e dërguar me postë dhe konfirmimi i shërbimit postar për dërgimin e kësaj letre me kthim përgjigje.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

Elton Tirana

Auditues Ligjor





Tiranë

26/05/2022

Kontakt:

Elton Tirana

E-mail:

elton.tirana@studiotirana.com

Cel: +355 699 325 722

Drejtuar : "Partia Alternative Republikane"

Në vëmendje të: Z. Shemsedin Memia

Objekti: **Njoftim**

Me anë të kësaj shkrese z. Elton Tirana, auditues ligjor me numër liçense 257, datë 27/08/2012 njofton z. Shemsedin Memia, në cilësinë e kryetarit të "Partia Alternative Republikane" bazuar në kontratën e shërbimit nr. Prot 2336, datë 09/05/2022 lidhur me Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve, i përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. Ylli Merkaç

me mision "Kryerja e auditimit të detyrueshëm të partive politike, të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2021", kërkoj nga ana juaj të pajisem me informacionin e nevojshëm p për kryerjen e detyrës së caktuar më sipër.

Në mungesë të informacioneve në lidhje me personin përgjegjës kontakt për partinë tuaj po ju dërgoj këtë shkresë informuese në adresën deklaruar nga ana juaj si mëposhtë:

Partia Alternative Republikane, Tiranë

Në pritje të një përgjigje nga ana juaj ju vendos në dispozicion dis

1. Cel +355 699 325 722
2. E-mail: elton.tirana@studiotirana.com
3. Adresa: Tiranë, Njësia Bashkiake nr.5, Rruga Medar Shtyl

Duke shpresuar në bashkëpunimin tuaj.

Me respekt,

Elton Tirana



STUDIO TIRANA

Nr:

1019

DEFTESE

30/05/2022 15:19:02

PRANIMI E OBJEKTEVE POSTARE

Objekti	Letra	Leter
KOD-BAR		RR033445957AA
Derguesi		ELTON TIRANA
Marresi		P ALTERNATIVE REPUBLIKANE
Vendim marritja		TIRANA
Peshë		20 gr
LM		RR035847485AA

Sherbime të vecanta

LM ne postim 50

Tarifa Shtese 50

Tarifa Postare 70

Tarifa Totale 120

zëgjori: Elton Tirana (Auditorues Ligjor)
rjesia Basunioke nr. 5
ruga: Medor Sutylle
kompleksi kika 1,
Nd. 47, H. 23, Ap. 8
Tirane



Mom. Partia Alternative
Republikane

Tirane



POSTA SHQIPTARE sh.a.
Zyra Postare



Plotësohet nga dërguesi
i cili duhet të tregojë drejtimin
e tij të plotë për kthimin
e këtij lajmërimi

MOD P6

KTHEHET	
IPANJOHUR	<input checked="" type="checkbox"/>
LARGUAR	<input type="checkbox"/>
ADRESE E PAMJAFTUESHME	<input type="checkbox"/>
KANDRYSHUAR ADRESE	<input type="checkbox"/>
OBJEKTI PA KERKUAR	<input type="checkbox"/>
REFUZUAR	<input type="checkbox"/>
ADRESE E PASAKTE	<input type="checkbox"/>
DATA E KTHIMIT	

ENR

e së Lajmërimit

Ky lajmërim - marrje do të kthehet
në adresën time si më poshtë:

z Elton Tirana
rjesia Basunioke Nr 5
ruga Medor Sutylle
kompleksi kika 1,
Nd. 47, H. 23, Ap. 8
Tirane